




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës
Opština Mitrovica - Mitrovica Municipality




DREJTORIA E MBROJTJES SË MJEDISIT DHE PYJEVE



PLANI DHE PROGRAMI I PUNËS PËR VITIN 2026

KOMUNA E MITROVICËS
Drejtoria e Mbrojtjes së Mjedisit



Mitrovicë
Janar-2026

PLANI I PUNËS SË DREJTORISË PËR MBROJTJEN E MJEDISIT DHE PYJEVE PËR PERIUdhËN JANAR-DHJETOR 2026



Plani i Punës së Drejtorisë për Mbrojtjen e Mjedisit për periudhën janar–dhjetor 2026 paraqet kornizën strategjike dhe operative të angazhimeve tona institucionale në fushën e mbrojtjes së mjedisit për vitin e ardhshëm.

Ky dokument reflekton përkushtimin e Komunës së Mitrovicës për të siguruar një mjedis të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm për të gjithë qytetarët. Duke u bazuar në sfidat aktuale mjedisore dhe ndikimin e tyre në cilësinë e jetesës, kemi përcaktuar objektiva të qarta dhe aktivitete konkrete që synojnë adresimin e çështjeve prioritare në mënyrë sistematike dhe të vazhdueshme.

Objektivat kryesore për vitin 2026 përfshijnë:

- **Fuqizimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave** në komunë, duke përfshirë përmirësimin e inkasimit, zgjerimin e mbulueshmërisë së shërbimeve dhe trajtimin efikas të kërkesave për Leje Mjedisore Komunale;
- **Monitorimin e vazhdueshëm të gjendjes mjedisore**, përfshirë cilësinë e ajrit, ujit, tokës dhe biodiversitetit, në bashkëpunim me institucionet qendrore dhe partnerët ndërkombëtarë;
- **Zgjerimin e sipërfaqeve të gjelbëruara** përmes programit gjithëpërfshirës të gjelbërimit, i cili përfshin mbjelljen e fidanëve në hapësira publike dhe institucione arsimore;
- **Ngritjen e vetëdijes mjedisore** të qytetarëve përmes fushatave edukative dhe bashkëpunimit me institucionet arsimore, organizatat e shoqërisë civile dhe mediat.

Realizimi i këtij plani kërkon angazhim të përbashkët dhe bashkëpunim ndërinstitutional. Jam e bindur se, me përkushtimin e stafit të Drejtorisë dhe mbështetjen e të gjitha palëve të interesit, do të arrijmë rezultate të prekshme në përmirësimin e cilësisë së mjedisit dhe, rrjedhimisht, të cilësisë së jetesës në Komunën e Mitrovicës.

Arjeta Beqiri Hyseni

*Drejtore e Drejtorisë për Mbrojtjen e Mjedisit
Mitrovicë, Janar 2026*

1. HYRJE

Plani i Punës së Drejtorisë për Mbrojtjen e Mjedisit për periudhën janar–dhjetor 2026 përcakton kornizën strategjike dhe operative të aktiviteteve që synojnë mbrojtjen, ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit në territorin e Komunës së Mitrovicës.

Ky dokument është hartuar në përputhje me:

- Ligjin Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit;
- Ligjin Nr. 04/L-060 për Mbeturina;
- Rregulloren për menaxhimin e mbeturinave 02/2022
- Planin Lokal për Mbrojtjen e Mjedisit;
- Planin Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave (PKMM);
- Udhëzimet Administrative të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Drejtoria për Mbrojtjen e Mjedisit, si njësi organizative e administratës komunale, mbetet e përkushtuar në zbatimin e politikave mjedisore që sigurojnë zhvillim të qëndrueshëm dhe përmirësim të cilësisë së jetesës për të gjithë banorët e komunës.

2. VIZIONI DHE MISIONI

2.1 Vizioni

Mitrovica – komunë me mjedis të pastër, të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm, ku cilësia e ajrit, ujit dhe tokës përmbush standardet evropiane dhe ku hapësirat e gjelbëruara kontribuojnë në mirëqenien e qytetarëve.

2.2 Misioni

Zbatimi i politikave efektive mjedisore përmes:

- Menaxhimit të integruar të mbeturinave;
- Monitorimit të vazhdueshëm të parametrave mjedisorë;
- Zgjerimit të sipërfaqeve të gjelbëruara;
- Edukimit dhe vetëdijesimit të komunitetit;
- Bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërsektorial.

3. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE PËR VITIN 2026

3.1 Objektivi 1: Menaxhimi i Qëndrueshëm i Mbeturinave

- Zgjerimi i mbulueshmërisë së shërbimeve të grumbullimit;
- Promovimi i ndarjes në burim dhe riciklimit;
- Trajtimi efikas i kërkesave për Leje Mjedisore Komunale (LMK).

3.2 Objektivi 2: Monitorimi dhe Mbrojtja e Cilësisë së Mjedisit

- Monitorimi i cilësisë së ajrit, ujit dhe tokës;
- Identifikimi dhe trajtimi i zonave të kontaminuara;
- Mbrojtja e popullatës nga ndotja me metale të rënda;
- Bashkëpunimi me institucionet qendrore për vendosjen e pajisjeve monitoruese.

3.3 Objektivi 3: Zgjerimi i Sipërfaqeve të Gjelbëruara

- Realizimi i programit gjithëpërfshirës të gjelbërimit;
- Shpërndarja dhe mbjellja e fidanëve në hapësira publike dhe institucione arsimore;
- Implementimi i sistemeve të ujitjes me ujë industrial për reduktimin e ndotjes.

3.4 Objektivi 4: Edukimi dhe Vetëdijesimi Mjedisor

- Organizimi i fushatave ndërgjegjëse;
- Bashkëpunimi me institucionet arsimore dhe organizatat e shoqërisë civile;
- Shënimi i ditëve botërore të mjedisit.

3.5 Objektivi 5: Harmonizimi Ligjor dhe Institucional

- Harmonizimi i rregulloreve komunale me legjislacionin kombëtar dhe standardet e BE-së;
- Zbatimi i strategjive dhe planeve të veprimit mjedisor.

4. AKTIVITETET KRYESORE TË PLANIFIKUARA

4.1 Menaxhimi i Mbeturinave

Nr.	Aktiviteti	Rezultati i Pritur
1	Zbatimi i PKMM-së sipas masave të parapara	Sistem funksional i menaxhimit të mbeturinave
2	Monitorimi i shërbimeve të KRM "Uniteti" Sh.A.	Raporte të rregullta mbi performancën
3	Hartimi i raporteve periodike për MMPHI	Përmbushje e detyrimeve ligjore
4	Zbatimi i rregullores komunale për mbeturina	Rritje e disiplinës mjedisore
5	Monitorimi i deponisë së mbeturinave në Gërmovë	Operim i kontrolluar i deponisë
6	Implementimi i ndarjes në burim	Rritje e shkallës së riciklimit
7	Vendosja e kontejnerëve për ndarje në lokacione strategjike	Lehtësim i procesit të riciklimit

4.2 Monitorimi Mjedisor

Nr.	Aktiviteti	Rezultati i Pritur
1	Monitorimi i cilësisë së ajrit	Të dhëna të sakta për vendimmarrje
2	Monitorimi i cilësisë së ujit	Identifikimi i burimeve të ndotjes
3	Analiza e tokës në zona të kontaminuara	Harta e rrezikut mjedisor
4	Vlerësimi i nivelit të zhurmës	Masa për reduktimin e zhurmës
5	Blerja e pajisjeve për monitorim të ajrit	Kapacitete të shtuara monitoruese

4.3 Gjellërimi dhe Rivitalizimi

Nr.	Aktiviteti	Rezultati i Pritur
1	Mbjellja e fidanëve në hapësira publike	Rritje e sipërfaqeve të gjellëruara
2	Mbjellja e fidanëve në institucione arsimore	Mjedis më i shëndetshëm për fëmijë
3	Mirëmbajtja e zonave të gjellëruara ekzistuese	Ruajtje e investimeve të mëhershme
4	Rivitalizimi i hapësirave urbane dhe rurale	Përmirësim i pamjes së qytetit
5	Vendosja e elementeve urbane (ulëse, shporta)	Funksionalitet i shtuar i hapësirave

4.4 Fushatat Vetëdijesuese

Nr.	Aktiviteti	Rezultati i Pritur
1	Dita Botërore e Tokës (22 Prill)	Angazhim i komunitetit
2	Dita Botërore e Mjedisit (5 Qershor)	Rritje e vetëdijes mjedisore
3	Fushata "Mbroni fëmijët nga helmimi me plumb"	Mbrojtje e shëndetit publik
4	Aktivitetet edukative në shkollë	Edukimi i brezave të rinj
5	Tryeza dhe punëtori me palët e interesit	Bashkëpunim i zgjeruar

5. PROGRAMI I GJELLËRIMIT DHE SHPËRNDARJES SË FIDANËVE

5.1 Përshkrimi i Programit

Drejtoria për Mbrojtjen e Mjedisit, në kuadër të angazhimeve për zgjerimin e sipërfaqeve të gjellëruara dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit, ka planifikuar realizimin e një programi gjithëpërfshirës të gjellëimit për vitin 2026.

5.2 Inventari i Fidanëve

Kategoria	Sasia (copë)	Lloji i Fidanëve
Hapësira publike të qytetit	500	Pisha e zezë, Pisha Hartin
Institucione arsimore (shkollë dhe qerdhe)	2,800	Pisha e zezë, Pisha Hartin
GJITHSEJ	3,300	

6. PLANI OPERATIV MUJOR

JANAR 2026

Nr.	Objektiva	Detyrat	Aktivitetet	Organi Përgjegjës Parësor	Organi Përgjegjës Dytësor
1	Zbatimi i PKMM-së	Zbatimi sipas masave të parapara	Miratimi dhe implementimi i planit	DMM	Kuvendi Komunal, Komuniteti
2	Monitorimi i sistemit të mbeturinave	Bashkëpunim me GIZ dhe MMPHI	Raportimi në AMMK dhe GIZ	DMM	KRM "Uniteti" Sh.A.
3	Hartimi i Raportit Vjetor 2025	Grumbullimi dhe analizimi i të dhënave	Dorëzimi i raportit në MMPHI	DMM	KRM "Uniteti" Sh.A.
4	Zbatimi i Ligjit VNM dhe UA për LMK	Harmonizimi me rregullore komunale	Trajtimi i kërkesave për LMK	DMM	MMPHI
5	Fillimi i koordinimit për programin e gjelbërimit	Komunikimi me DKA	Kërkesa zyrtare për bashkëpunim	DMM	DKA

SHKURT 2026

Nr.	Objektiva	Detyrat	Aktivitetet	Organi Përgjegjës Parësor	Organi Përgjegjës Dytësor
1	Aktivite të vetëdijesuese	Propozimi i projekteve	Bashkëpunim me UMIB	DMM	Universiteti i Mitrovicës
2	Monitorimi i zonave të mbrojtura	Procedimi sipas PLVM	Hartimi i planit të veprimit	DMM	MMPHI, Komuniteti
3	Monitorimi i deponisë në Gërmovë	Vlerësimi i gjendjes	Vizita në teren, raportimi	DMM	KRM "Uniteti" Sh.A.
4	Monitorimi i lokacioneve për gjueti	Vlerësimi i gjendjes	Bashkëpunim me Shoqatën "Trepça"	DMM	MMPHI
5	Organizimi i tryezës për mjedisin	Përgatitja e agjendës	Ftesa e palëve të interesit	DMM	UMIB, OJQ-të
6	Vlerësimi i institucioneve arsimore	Koordinimi me DKA	Inspektimi i oboreve të shkollave	DMM	DKA

MARS 2026

Nr.	Objektiva	Detyrat	Aktivitetet	Organi Përgjegjës Parësor	Organi Përgjegjës Dytësor
1	Monitorimi i deponisë në Gërmovë	Vlerësimi i mbulimit të rregullt	Pranimi i raporteve nga kompania	DMM	Kuvendi Komunal
2	Zbatimi i Ligjit VNM dhe UA për LMK	Harmonizimi me rregullore	Trajtimi i aplikacioneve	DMM	MMPHI
3	Aktivitetet vetëdijësuese	Propozimi i projekteve	Përzgjedhja e aktiviteteve	DMM	Universiteti i Mitrovicës
4	Monitorimi i menaxhimit të mbeturinave	Vlerësimi i gjendjes	Vizita në teren	DMM	KRM "Uniteti" Sh.A.
5	Finalizimi i listës së institucioneve arsimore	Përcaktimi i sasive për çdo institucion	Nënshkrimi i marrëveshjes me DKA	DMM	DKA
6	Përgatitja teknike për mbjellje	Prokurimi i materialeve ndihmëse	Sigurimi i logjistikës	DMM	DSHPI

PRILL 2026

Nr.	Objektiva	Detyrat	Aktivitetet	Organi Përgjegjës Parësor	Organi Përgjegjës Dytësor
1	Monitorimi i lokacioneve për gjueti	Vlerësimi i gjendjes	Bashkëpunimi me Shoqatën "Trepça"	DMM	MMPHI
2	Zbatimi i rregullores komunale	Procedimi sipas nevojës	Propozime për plotësim/ndryshim	DMM	Komuniteti
3	Dita Botërore e Tokës – 22 Prilli	Përzgjedhja e shkollave	Pastrimi i qytetit, aktivitete vetëdijësuese	DMM	DKA, Shkollat
4	Monitorimi i cilësisë së ajrit	Kontrolli i sistemeve monitoruese	Marrja dhe vlerësimi i rezultateve	DMM	MMPHI
5	Monitorimi i	Vlerësimi i gjendjes	Vizita në teren	DMM	KRM "Uniteti" Sh.A.

	menaxhimit në Gërmovë				
6	Fillimi i mbjelljes së fidanëve (Faza I)	Koordinimi me DKA dhe shkollat	Mbjellja në institucionet e përzgjedhura	DMM	DKA, Shkollat

MAJ 2026

Nr	Objektiva	Detyrat	Aktivitetet	Organi Përgjegjës Parësor	Organi Përgjegjës Dytësor
1	Shtimi i sipërfaqeve të gjelbëruara	Vlerësimi dhe projektimi	Mbjellja e drunjve dhe luleve	DSHPI	DMM
2	Aktivitetet me OJQ lokale	Takime pune	Nxjerrja e rekomandimeve	DMM	OJQ-të
3	Vazhdimi i mbjelljes së fidanëve	Implementim i sipas planit	Mbjellja e 500 fidanëve në hapësira publike	DMM	DSHPI
4	Mbjellja në institucionet e arsimore	Koordinimi me shkollat	Mbjellja sipas listës së aprovuar	DMM	DKA, Shkollat
5	Monitorimi i fidanëve të mbjellur	Vlerësimi i gjendjes	Raportimi i shkallës së mbijetesës	DMM	DKA

QERSHOR 2026

Nr.	Objektiva	Detyrat	Aktivitetet	Organi Përgjegjës Parësor	Organi Përgjegjës Dytësor
1	Monitorimi i deponisë në Gërmovë	Vlerësimi i gjendjes	Vizita në teren	DMM	KRM "Uniteti" Sh.A.
2	Monitorimi i cilësisë së ajrit, ujit dhe tokës	Kontrolli i sistemeve	Marrja dhe vlerësimi i rezultateve	DMM	MMPHI
3	Vendosja e shportave për ndarje në burim	Identifikimi i lokacioneve	Vendosja në Tunel të Parë dhe qytet	DMM	KRM "Uniteti" Sh.A.
4	Blerja e	Bashkëaplikimi	Prokurimi i	DMM	OJQ-të/Donator

	pajisjeve monitoruese	në fonde	pajisjeve		
5	Rregullimi i PGM-ve në rrugët e qytetit	Procedurat e prokurimit	Implementimi i projektit	DMM	DSHPI
6	Dita Botërore e Mjedisit – 5 Qershori	Organizimi i aktiviteteve	Fushata publike, ngritje vetëdijeje	DMM	DKA, OJQ-të, Media

KORRIK 2026

Nr.	Objektiva	Detyrat	Aktivitetet	Organi Përgjegjës Parësor	Organi Përgjegjës Dytësor
1	Aktivite me OJQ lokale	Takime pune	Nxjerrja e rekomandimeve	DMM	OJQ-të
2	Hartimi i raportit gjashtëmujor	Vlerësimi i punëve të realizuara	Përshkrimi i aktiviteteve	DMM	-
3	Kontrollimi i sipërfaqeve të gjelbëruara	Vlerësimi i gjendjes	Identifikimi i nevojave për ndërhyrje	DMM	DSHPI
4	Monitorimi i fidanëve të mbjellur	Vlerësimi i rritjes	Raportimi dhe masa korrigjuese	DMM	DKA

GUSHT 2026

Nr.	Objektiva	Detyrat	Aktivitetet	Organi Përgjegjës Parësor	Organi Përgjegjës Dytësor
1	Monitorimi i gjendjes së lumenjve	Vlerësimi dhe projektimi	Pastrimi, heqja e mbeturinave	DMM	KRM "Uniteti" Sh.A.
2	Monitorimi i Planit Operativ për Mbeturina	Vlerësimi i implementimit	Raportimi i progresit	DMM	KRM "Uniteti" Sh.A.
3	Planifikimi i buxhetit për vitin 2027	Vlerësimi i nevojave	Hartimi i propozim-buxhetit	DMM	Drejtoria e Financave
4	Mirëmbajtja e zonave të gjelbëruara	Ujitja dhe kujdesi	Sigurimi i mbijetesës së bimësisë	DMM	DSHPI

SHTATOR 2026

Nr.	Objektiva	Detyrat	Aktivitetet	Organi Përgjegjës Parësor	Organi Përgjegjës Dytësor
1	Fushatat vetëdijesuese	Organizimi i aktiviteteve	Bashkëpunimi me shkollat	DMM	DKA
2	Monitorimi i deponisë në Gërmovë	Vlerësimi i gjendjes	Vizita në teren	DMM	KRM "Uniteti" Sh.A.
3	Vlerësimi i gjendjes së mjedisit	Analizimi i të dhënave	Hartimi i raportit të ndërmjetëm	DMM	MMPHI
4	Përgatitja për mbjelljen e vjeshtës	Identifikimi i lokacioneve	Planifikimi i Fazës II të gjelbërimit	DMM	DKA, DSHPI

TETOR 2026

Nr.	Objektiva	Detyrat	Aktivitetet	Organi Përgjegjës Parësor	Organi Përgjegjës Dytësor
1	Shtimi i sipërfaqeve të gjelbëruara	Vlerësimi dhe projektimi	Mbjellja e fidanëve (sezoni i vjeshtës)	DSHPI	DMM
2	Vlerësimi i nivelit të zhurmës	Hartimi i raportit	Procedimi në Kuvend	DMM	Kuvendi Komunal
3	Monitorimi i fidanëve të mbjellur në pranverë	Vlerësimi i gjendjes	Masa korrigjuese sipas nevojës	DMM	DKA

NËNTOR 2026

Nr.	Objektiva	Detyrat	Aktivitetet	Organi Përgjegjës Parësor	Organi Përgjegjës Dytësor
1	Aktivitetet me OJQ lokale	Takime pune	Nxjerrja e rekomandimeve	DMM	OJQ-të
2	Monitorimi i sipërfaqeve të gjelbëruara	Vlerësimi i gjendjes	Raportimi i rezultateve	DMM	DSHPI
3	Raporti i gjendjes së mjedisit	Vlerësimi gjithëpërfshirës	Procedimi në Kuvend	DMM	Kuvendi Komunal

	2026				
4	Fushatat vetëdijesues e	Organizimi i aktiviteteve	Bashkëpunimi me shkollat	DMM	DKA
5	Vlerësimi i programit të gjelbërimit	Analizimi i rezultateve	Raporti përfundimtar për fidanët	DMM	DKA

DHJETOR 2026

Nr.	Objektiva	Detyrat	Aktivitetet	Organi Përgjegjës Parësor	Organi Përgjegjës Dytësor
1	Aktivitete me OJQ lokale	Takime pune	Vlerësimi vjetor i bashkëpunimit	DMM	OJQ-të
2	Vlerësimi i gjendjes mjedisore	Monitorimi përfundimtar	Analizimi i treguesve të cilësisë	DMM	MMPHI
3	Raporti Vjetor 2026	Konsolidimi i të dhënave	Hartimi dhe aprovimi i raportit	DMM	Kuvendi Komunal
4	Plani i Punës 2027	Planifikimi strategjik	Hartimi dhe procedimi i planit	DMM	Kuvendi Komunal
5	Raporti përfundimtar i programit të gjelbërimit	Vlerësimi i shkallës së realizimit	Dokumentimi i mësimave të nxjerra	DMM	DKA

7. PËRFUNDIME

Plani i Punës për vitin 2026 përcakton një kornizë të qartë dhe të matshme për aktivitetet e Drejtorisë për Mbrojtjen e Mjedisit. Prioritet të veçantë ka programi i gjelbërimit, i cili parasheh shpërndarjen dhe mbjelljen e 3,300 fidanëve, duke kontribuar drejtpërdrejt në:

- Përmirësimin e cilësisë së ajrit;
- Reduktimin e efekteve të ngrohjes urbane;
- Krijimin e mjedisit më të shëndetshëm për fëmijët dhe qytetarët;
- Edukimin mjedisor të brezave të rinj.

Realizimi i suksesshëm i këtij plani kërkon bashkëpunim të ngushtë ndërinstitucional, veçanërisht me Drejtorinë Komunale të Arsimit, si dhe angazhim të komunitetit dhe organizatave të shoqërisë civile.

Drejtoria për Mbrojtjen e Mjedisit mbetet e përkushtuar për zbatimin e plotë të këtij plani dhe raportimin e rregullt mbi progresin e arritur.

HARTUAR NGA: Drejtoria për Mbrojtjen e Mjedisit, Komuna e Mitrovicës

DREJTORE:

Arjeta Beqiri Hyseni

